



# CENSIMENTI PERMANENTI POPOLAZIONE E ABITAZIONI



## PYETJET E PYETËSORIT: MË SHUMË INFORMACIONE

### BANESA

#### 1 Lloji i banesës

##### Pyetja 1.1 Tregoni llojin e banesës

###### MOD. 1 Banesë

Lokal (ose një bashkësi lokale) që përdoret zakonisht për tu banuar dhe që është:

- i rrethuar me mure dhe i mbuluar me çati;
- i pajisur të paktën me një hyrje të pavarur nga përjashta ose me hapësira me kalim të përbashkët (siç është rruga, pjesa para shtëpisë, shkallët, kryeshkallët, korridoret, tarracat, etj.) pra në mënyrë që të hysh në të pa kaluar detyrimisht nëpërmes banesave të tjera;
- pjesë e një ndërtese (ose që vetë përbën një ndërtesë).

Familja e cila banon në një seli diplomatike apo të konsullatës duhet të seleksionojë **Banesë e tjetër lloji**.

###### MOD. 2 Banesë e tjetër lloji

Strukturë që nuk paraqet karakteristikat e banesës sepse është e lëvizshme, pjesërisht e përkohshme apo e çastit, e banuar nga një apo më shumë persona si banesë e zakonshme ose e përkohshme (psh karvan, tendë, kamp, barake, shpellë, garazh, kantinë, stallë, etj.).

###### MOD. 3 Strukturë rezidenciale e përbashkët

Strukturë e përdorur për t'ju banuar një grup personash dhe/ose një apo më shumë familje. Në këtë kategori

hyjnë hotelet, spitalet, azil pleqsh, qendrat e mirëpritjes, institute të llojeve të ndryshme (fetare, për kurim, për asistencë, për mësimdhënie, etj.).

Për shembull, një familje që banon zakonisht në një rezidencë ose në një dhomë hoteli ose familjet që kanë marrë vendbanim në banesa që gjinden brënda strukturave rezidenciale të përbashkëta (si familja e rojës së spitalit i cili jeton brënda strukturës), hyn në këtë kategori.

##### Pyetja 1.3 Banesa është e zënë nga

###### MOD. 2 Bashkëjetojnë më shumë se një familje

Bashkëjetesa në të njëjtën banesë të disa personave mund të kuptohet si trungje familjesh të ndryshme vetëm në mungesë të lidhjes nga afërsia ose afektive midis personave që e banojnë atë.

##### Pyetja 1.4 Tregoni numrin e përgjithshëm të pjesëtarëve të të gjitha familjeve që bashkëbanojnë

Tregoni numrin komplet të familjeve të cilat bashkëjetojnë në banesë. Llogaritni edhe pjesëtarët e familjes që përpilojnë pyetësin.

##### Pyetja 1.5 Me çfarë titulli familja Juaj ka zënë banesën?

Seleksiononi arsyen "Pronë (e plotë ose e pjeshme)" në rastet kur banesa është: në pronësi, ekskluzive apo e ndarë midis personave që e banojnë atë.

Seleksioni arsyen “Qira” ose “Tjetër titull (falas, për kryerje shërbimesh, etj) kur banesa nuk është pronë e askujt prej personave që e banojnë, por është marrë me qira ose është zënë me titull tjetër.

Seleksioni “Uzefrukt ose përfitim pronësie” në rastet kur banohet në banesën nga e drejta e uzefruktit (për shembull është shitur vetëm pronësia pa të drejtë përdorimi) ose ngaqë gëzohet një e drejtë tjetër reale (psh. përdorimi, banimi) ose në rastet kur banesa është objekt përfitimi pronësie.

### **Pyetja 1.6** Banesa është marrë me qira e mobiluar?

Banesa mund të konsiderohet e mobiluar kur është pajisur me mobiliet e duhura për jetesën në të.

## **2** Karakteristikat e banesës

### **Pyetja 2.1** Kush është pronari i banesës?

Nëse prona është e ndarë midis subjekteve të ndryshëm (private, biznese, etj.) tregoni pronarin i cili përmban kuotën më të madhe të pronësisë. Në rast pronësie të zhveshur nga e drejta për banim referohuni pronarit të pronësisë të zhveshur.

### **Pyetja 2.2** Cila është sipërfaqja e banesës?

Nëse banesa ngrihet në më shumë se një nivel, ose përfshin dhoma me hyrje të pavarur, duhet të mblidhet sipërfaqja e të gjithë pjesëve.

Sipërfaqja e shkelur është ajo e dyshemesë duke hequr masën e mureve.

### **Pyetja 2.3** Sa dhoma ka banesa?

**Përfshihen** nga llogaritja:

- dhomat pa dritare përveç rastit kur kryejnë funksione shtëpiake (për shembull dhoma e gjumit).

Duhet **përfshirë** në llogaritje:

- dhomat me aneks kuzhine që përdoren për shume aktivitete;
- dhomat me hyrje të pavarur, por të lidhura me banesën në mënyrë funksionale dhe që përdoren prej familjes.

Një banesë e madhe e formuar në shumë pjesë me funksione të ndryshme, ose e ndarë në dy ose më shumë harqe ose nga ndarëse të lëvizshme, duhet të llogaritet si shumë dhoma dhe jo si një e vetme.

## **3** Impianti klimatik (ngrohje, kondicioner)

### **Pyetja 3.1** Shënoni impiantin e ngrohjes të banesës

**MOD. 1** Impiant i centralizuar që përdoret për shumë banesa

Impiant ngrohjeje për të gjitha banesat e ndërtesës dhe i vendosur jashtë banese, për shembull në lokalet anësore të ndërtesës (kantinë, depo nëntokësore, tarracë, etj.) përdorimi i të cilit mund të kryhet në mënyrë autonome.

Konsiderohet i centralizuar edhe impianti i lidhur me rrjetin qytetar të auto-komanduar.

**MOD. 2** Impiant autonom personal me përdorim eksklusiv të banesës

Impiant ngrohjeje për një banesë të vetme dhe zakonisht e lokalizuar brënda saj ose pranë saj (p.sh. kaldajë e vendosur në një cep brënda ballkonit apo tarracës, panele diellorë, etj.), përdorimi i të cilit është autonom.

**MOD. 3** Aparatura të vetme të fiksuara

Aparatura që nuk lidhen me impiantin e centralizuar ose të fiksuara dhe autonome, që nuk mund të transportohen: për shembull oxhaqet, termosifonet personale e fiksuara, vatrat elektrike, sobat.

### **Pyetja 3.3** Banesa është e pajisur me impiant fiks kondicioner?

Të kuptohet me impiant fiks ai i tipit Split, fiks monoblok, me panele rrezatuese në dysHEME/mur/tavan etj.

Të **përfshihen** kondicionerët e lëvizshëm.

## **4** Karakteristikat e ndërtesës

### **Pyetja 4.1** Në çfarë lloji ndërtesë ndodhet banesa juaj?

**MOD. 1** Rezidenciale (ndërtesë për banim ose kryesisht për banim)

Ndërtesë e projektuar dhe e ndërtuar për tu banuar (për shembull shtëpi vetjake, vila, shtëpi njëra pas tjetrës, pallate në komplekse rezidenciale, etj.) edhe nëse brënda tyre gjejnë studio profesionale, agjenci shërbimesh dhe biznese tregtare.

MOD. 2 Jo rezidenciale (ndërtesë që NUK përdoret për tu banuar ose kryesisht NUK përdoret për tu banuar)

Ndërtesë e projektuar dhe e ndërtuar ekskluzivisht ose kryesisht për qëllime mos banimi (për shembull ndërtesë shkollore, fabrika ose të ngjashme e cila përmbledh brënda saj banesën e rojës).

#### **Pyetja 4.2** Në cilën periudhë është ndërtuar ndërtesa?

Nëse ndërtesa ka pësuar, gjatë kohës, një rikonstruksion të përgjithshëm, duhet shkruar viti i rikonstruksionit. Për rikonstruksion të përgjithshëm kuptohet modifikim i strukturës mbajtëse të ndërtesës.

#### **Pyetja 4.3** Sa njësi përbëjnë ndërtesën?

Kuptohet bashkësia e njërive për banim që ndodhen në ndërtesë, tek të cilat mund të hysh nëpërmjet pjesëve të përbashkëta (shkallëve, hyrjes apo oborrit) të vetë ndërtesës.

#### **Pyetja 4.4** Në cilin kat të ndërtesës ndodhet banesa juaj?

MOD. 1 Kati i -1 ose i poshtëm (nëntokësor ose gjysmë-nëntokësor)

Paraqet katin që ndodhet komplet ose pjesërisht në nivelin e rrugës.

#### **Pyetja 4.5** Shkruani numrin e kateve jashtë toke të ndërtesës

Shkruani numrin e kateve që dalin jashtë nivelit të rrugës, tërësisht ose pjesërisht. Kati i tokës duhet të llogaritet si kati nr. 1. Për shembull, një ndërtesë me një kat tokësor, të parë, të dytë dhe kat të tretë duhet konsideruar si pallat katër katesh. Një vilë me një kat tokësor duhet konsideruar si njëkatëshe.

#### **Pyetja 4.6** Ndërtesa ka ashensor?

Konsideroni ashensorë, të brendshëm dhe të jashtëm, të cilët i shërbejnë kateve të pallatit.

#### **Pyetja 4.7** Ashensori është i përshtatshëm për transportimin e personave me aftësi të kufizuar lëvizëse?

Ashensori duhet të ketë dyer të llojit automatik dhe një kabinë të tillë që të mundësojë hyrjen e personave me karrocë ose me deambulator.

5

## Automjete dhe vend parkingu

### **Pyetja 5.1** Familja juaj disponon automjete?

Për disponim kuptohet jo vetëm prona e automjetit, por edhe mundësi përdorimi të tjera në mënyrë ekskluzive nga një pjesëtar i familjes (qira afatgjatë, përdorues, i caktuar me ligj, etj.).

### **Pyetja 5.2** Familja juaj disponon një apo disa vende parkingu personale për automjetin?

Për disponim kuptohet përdorimi i parkingut në mënyrë personale dhe e garantuar si e tillë (përdorimi i tij në çdo moment) sepse pjesë e pronës, e marrë me qira, falas etj.

### **Pyetja 5.2.1** Bëhet fjalë (munden më shumë se një përgjigje):

MOD. 1 Boks makine

Vend i mbyllur, i përshtatshëm për një ose më shumë automjetesh, dhe i përdorur për këtë qëllim.

MOD. 2 Vend për makinë i mbuluar

I vendosur në një lokal të mbyllur i përshtatshëm për vendosjen e një ose më shumë makinash dhe i përdorur për këtë qëllim: për shembull, garazhet e pallatit që gjinden poshtë ndërtesave ose garazhet e gjendura në ndërtesa të krijuara posaçërisht.

MOD. 3 Vend makine në hapësirë të rezervuar

Ndodhet në hapësirën e jashtme: për shembull, brenda oborreve, në katin me kolona poshtë pallatit, në katin e fundit dhe të zbuluar të ndërtesës i krijuar për parking ose për përdorime të ngjashme.

## SKEDA PERSONALE

1

### Të dhëna civile, gjendja civile dhe martesë

#### **Pyetja 1.1** Lidhja midis të afërmeve ose i bashkëjetesës në familje me personi në referim

- Fëmijët klasifikohen si të tillë nëse personi në referim e ka njohur atësinë gjithashtu/ose nga bashkëshorti/i lidhur në gjendjen civile/bashkëjetuesi.
- Të afërmit e bashkëshortit/të lidhurit në gjendjen civile/bashkëjetues të personit në referim duhet të seleksionojnë mënyrën përkatëse korrespondent për lidhjen, edhe nëse bashkëshorti/i lidhuri në gjendjen civile/bashkëjetuesi i personit në referim ka vdekur ose nuk banon me në banesë.
- Të afërmit e personit në referim dhe/ose të bashkëshortit/bashkëjetuesit të pa përmendura midis përgjigjeve (xhaxha apo dajë e personit të referuar ose e bashkëshortëve/bashkëjetuesve, etj, duhet të seleksionojnë mënyrën "Pjesëtar tjetër i personit të referuar dhe/ose bashkëshortit/të lidhur në gjendjen civile/bashkëjetuesi të personi në referim".
- Personat që banojnë zakonisht në këtë banesë dhe nuk janë të afërm të personit në referim dhe të bashkëshortit/të lidhur në gjendjen civile/bashkëjetuesit duhet të seleksionojnë mënyrën "Tjetër person bashkëjetues pa lidhje çiftëzimi, afërsie ose afiniteti", për shembull personeli i shërbimit në familje (shërbyes, bashkëpunues familjarë) që banojnë në mënyrë të zakonshme në banesë.

#### **MOD. 4** "Bashkëjetues i personit në referim (bashkim me konsensus)"

Personi që bashkëjeton në çift me personin e marrë në referim të familjes, qoftë në rast çiftesh të krijuara midis personave me seks të ndryshme, si edhe në rast çiftesh të formuara nga persona me seks të njëjtë (të cilët nuk janë bashkuar në gjendje civile sipas Ligjit 20 maj 2016, nr.76 neni 1 paragrafët 1-35).

#### **MOD. 5** Biri/bija e [EMËR MBIEMËR] e bashkëshortit/të lidhurit në gjendjen civile/bashkëjetuesit

Fëmijët duhen klasifikuar me këtë modalitet ("Biri/bija e personit në referim dhe e bashkëshortit/të lidhurit në gjendjen civile/bashkëjetuesit") nëse të dy prindërit banojnë zakonisht në banesë.

#### **Pyetja 1.2**

**Bashkëjetesa është regjistruar në gjendje civile sipas Ligjit nr. 76 i 20 Maj 2016, neni 1 paragrafët 36-65, që disiploon bashkëjetesat faktike?**

Sipas Ligjit të 20 majit 2016 nr 76 (Art 1 komi 36 dhe 37) për ata që "faktikisht bashkëjetojnë" kuptohen dy persona në moshë madhore të lidhura me stabilizim nga ndjenjat afektive midis çifteve dhe nga ndihma morale dhe materiale reciproke, pa pasur lidhje afërsie, afiniteti dhe adoptimi, nga martesë apo lidhja civile. Për tu siguruar nëse bashkëjetesa është stabël, pra për tu regjistruar, i referohemi deklaratës të zyrës civile pra te artikullit 4 dhe te shkronjës b) i komit 1 të artikulli 13 të rregullores pjesë e dekretit të Presidentit të republikës të 30 maj 1989, nr 223.

#### **Pyetja 1.6** Gjendja civile

##### **MOD. 2** I martuar

Janë të përfshirë personat e martuar të cilët jetojnë larg njëri-tjetrit për arsye që nuk varen nga ata apo arsye nevojë.

##### **MOD. 3** Të ndarë me fakte

Persona të martuara, martesë e të cilave është në krizë qoftë nëse banojnë në banesë të ndryshme apo ndajnë të njëjtën banesë.

##### **MOD. 5** I ndarë

Persona të martuar të cilat kanë kërkuar dhe u është njohur shturja e kurorës apo fundi i detyrave civile të martesës sipas Ligjit 1° dhjetor 1970, nr 898.

##### **MOD. 7** Të bashkuar në gjendje civile

Persona të cilët kanë formuar bashkim civil sipas Ligjit 20 maj 2016, nr.76 neni 1 paragrafët 1-35, që rregullojnë bashkimet civile midis personave të të njëjtit seks.

##### **MOD. 9** Të bashkuar në gjendje civile sepse kurora është shturur (gjendje divorci)

Persona të bashkuar në gjendje civile por që ju është njohur shturja e kurorës sipas Ligjit 20 maj 2016, nr.76 neni 1 paragrafët 1-35, që rregullon bashkimet civile midis personave të të njëjtit seks.

#### **Pyetja 1.7** Viti i martesës ose i bashkimit në gjendje civile

Në rast të më shumë se një martesë apo bashkimi, shkruani vitin e asaj të fundit.

### Pyetja 2.1 Cila është nënshtetësia Juaj?

#### MOD. 2 E huaj

Personat e huaj me shumë nënshtetësi (me përjashtim asaj italiane) duhet të specifikojnë vetëm një shtet të huaj nënshtetësie, sipas kësaj rregulle precedence: a) Shtete që i përkasin Bashkimit Evropian, b) Shtete të tjera. Në rast shtetësie të shumëfishtë brënda grupit a) ose grupit b), duhet specifikuar dhe zgjedhur vetëm një shtet i huaj.

Të miturit që lindin në Itali nga prindër me shtetësi të huaj nuk mund të konsiderohen shtetas italianë, me përjashtim të rasteve kur shteti italian, sipas Ligjit n. 91 datë 5 shkurt 1992, neni 1 paragrafi 1-rë, shkronja B, ua njeh atyre shprehimisht shtetësinë italiane.

#### MOD. 3 Apolide

Si Apolide njihen personat situata e të cilave për sa i përket nënshtetësisë nuk është qartësuar si vijim i një shkrirjeje, ndarjeje apo bashkimi Shtetesh.

### Pyetja 2.2 E keni nënshtetësinë italiane qëkur keni lindur?

Duhet të seleksionojë “Po” ai që ka nënshtetësinë italiane që kur ka lindur, edhe nëse ka lindur jashtë shtetit.

Duhet të seleksionojë “Jo”

- Ai që ka marrë nënshtetësinë pas një kërkesë të posaçme dhe aktit të njohjes nga autoritetet përkatëse;
- Ai që ka marrë nënshtetësinë italiane si rrjedhojë martese ose bashkimi civil, natyralizimi të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, lindjeje në Itali dhe vendqëndrim me ligj dhe pa shkëputje deri në moshën 18-vjeçare;
- Kush ka marrë nënshtetësinë italiane automatikisht, për shembull:
  - a) i mituri i cili ka marrë nënshtetësinë sepse i birësuar nga shtetas italian ose pas njohjes së amësisë apo atësisë (deklaratë gjyqësore mbi njohjen e fëmijës) nga ana e prindit italian;
  - b) fëmija i mitur bashkëjetues me kë ka marrë nënshtetësinë italiane.

### Pyetja 2.3.1 Specifikoni shtetit e huaj të shtetësisë së mëparshme.

Mund të shënoni edhe “Apolid”.

### Pyetja 3.1 Keni banuar ndonjëherë rregullisht jashtë shtetit?

Për banim të rregullt kuptohet prezenca stabël në një vend me idenë për të banuar aty, duke marrë rezidencë, pavarësisht nga vendlindja, nga nënshtetësia dhe nga transferimet e tjera të vend banesës së zakonshme në Itali.

Duhet të seleksionojë “Po” ai që ka banuar jashtë shtetit të paktën 12 muaj pa shkëputje (për arsye familjare, studimi, pune apo tjetër).

Duhet të seleksionojnë “Po” edhe ata të cilët kanë lindur jashtë shtetit dhe janë transferuar në Itali para se të kenë mbushur një vjeç.

### Pyetja 3.2 Tregoni muajin dhe vitin e transferimit më të fundit në Itali.

Ai që ka vend banuar zakonisht jashtë shtetit duhet të shkruajë muajin dhe vitin e fundit transferimit të përhershëm në Itali.

Transferimi kuptohet si ndryshëm i vend banesës së zakonshme dhe jo thjesht një vizitë në Vendin tonë.

### Pyetja 4.2 Cili është titulli i studimit më i lartë që keni marrë midis këtyre të radhitura?

Titujt e studimit të radhitur janë ato që merren në sistemin shkollor italian.

- Fëmijët që janë 9 ose më shumë vjeç dhe që shkojnë në shkollë fillore duhet të seleksionojnë formën “Asnjë titull studimi, por di të lexoj dhe të shkruaj”.
- Personat (në veçanti **qytetarët me nënshtetësi të huaj**) të cilët kanë marrë një titull më të lartë **jashtë shtetit** duhet të seleksionojnë titullin korrespondent në Itali.
- Nënshtetasit e huaj të cilët nuk kanë marrë asnjë titull duhet të zgjedhin midis “nuk kam titull studimi dhe nuk di as të lexoj dhe as të shkruaj” dhe “nuk kam titull studimi, por di të lexoj dhe të shkruaj” **duke ju referuar gjuhës mëmë.**

### MOD. 3 Diplomë fillore/ Vërtetim vlerësimi përfundimtar)

Përfshin edhe ata të cilët kanë një certifikatë e lëshuar pas mbarimit të shkollës shtetërore e përngjashme me atë të diplomës fillestare.

### MOD. 4 Diplomë e shkollës së mesme (nga viti 2007 e quajtur "Diplomë shkollërore dytësore e gradës së I") ose nisje profesionale (e marrë jo më pas vitit 1965)

Futen në këtë format edhe ata që:

- kanë marrë Përfundimin e ciklit elementar/të mesëm të Konservatorit muzikor ose të Akademisë Kombëtare të Vallëzimit (2-3 vjet), që korrespondon me titujt e ndër-mesëm të marra në konservatorin e Muzikës dhe Akademinë e Vallëzimit para reformës së vitit 1999 (Ligji nr. 508/99);
- kanë marrë diplomën finale të Konservatorit të muzikës ose si Valltar por jo diplomën e shkollës superiore të gradës së dytë.

### MOD. 5 Diplomë kualifikimi profesional e shkollës superiore dytësore (e gradës të II) 2-3 vjeçare e cila nuk vlen për regjistrimin në Universitet

Titull i marrë në Institut profesional ose Shkolla pedagogjike ose Institut i arteve, në përfundim të ciklit të studimeve superiore të gradës së dytë me afat nën 4 vjet (kurs 2-3 vjeçar) dhe nuk vlen për regjistrimin në universitet.

### MOD. 6 Certifikatë IFP për kualifikim profesional trevjeçar (operator)/Diplomë profesionale IFP për teknik (viti i katërt) (nga 2005)

Titull i marrë në përfundim të ciklit trevjeçar/katërvjeçar për shkollimin dhe formimin (IFP). IFP-të (reforma e studimeve superiore të gradës së dytë në vitin shkollor 2010/2011) janë cikle për shkollim dhe formim profesionale të menaxhuar nga sistemi rajonal. Lëshojnë kualifikime trevjeçare ose diploma katërvjeçare. Për tu regjistruar duhet të keni marrë Dëftesën e lirim/Diplomën e shkollimit dytësor të gradës së I".

Këto kurse zëvendësojnë për së tëri kurset trevjeçare të shkollave dytësore të gradës së dytë të cilat lëshonin një diplomë si kualifikim profesional të çaktivizuar nga viti shkollor 2010/2011.

### MOD. 7 Dëftesë pjekurie/Diplomë e shkollimit superior dytësor (të gradës së dytë) 4-5 vjeçar që është i vlefshëm për regjistrimin në Universitet

Titull i marrë në lice, Institut profesional, Shkollë pedagogjike, Institut artistik, Institut teknik ose Institut pedagogjik, pas mbarimit të ciklit të studimeve superiore dytësore 4-5 vjeçare (e quajtur edhe dëftesë pjekurie) e cila lejon regjistrimin në kurset universitare. Përfshihet edhe diploma e marrë mbas ndjekjes së vitit plotësues

(për shembull pas vitit të 5° të Institutit Pedagogjik) ose të ciklit të dytë të studimeve dytësore (për shembull pas vitit të 4° dhe 5° të Institutit profesional).

### MOD. 8 Certifikatë specializimi teknik superior IFTS (nga 2000)

Titull i lëshuar në fund të ciklit të shkollimit dhe formimit teknik të lartë (IFTS), pra kurse rajonale post-dytësore që zakonisht zgjasin 1 vit. Mund të regjistrohesh pasi është marrë diploma e shkollës dytësore të gradës së II (4-5 vjeçare) ose të diplomës profesionale si teknik, e marrë pas përfundimit të cikleve katërvjeçare për formimin profesional (IFP viti i IV). Në raste të rralla mund të regjistrohet edhe kush nuk ka diplomën 4-5 vjeçare, duke u siguruar mi kompetencat e tij.

### MOD. 9 Diploma për teknik i lartë ITS (kurs dyvjeçar) (nga 2013)

Titull i lëshuar nga Institutet Teknike Superiore (ITS). Kurset ITS janë aktive nga 2011 dhe zgjasin normalisht 2 vjet (rrallë herë deri në 3). Mund të regjistroheni pas marrjes së dëftesës së pjekurisë ose të shkollës dytësore të gradës së II (5 vjeçare).

### MOD. 10 Diploma e Akademisë ë arteve të bukura, Vallëzim, Dramaturgjii, Artistik, etj., Konservator (sistemi i vjetër)

Flasim për kurset e aktivizuara para se te krijoheshin kurset e Formimit të Lartë, Muzikor dhe Koreografik (AFAM) dhe përfshijnë:

- Diplome përfundimtare e marrë ne Akademinë e Arteve të Bukura, Akademinë kombëtare të vallëzimit, Konservatorin e muzikës, Institutin Superior për Industrinë Artistike (ISIA)- kurse të sistemit të vjetër, para reformës te sektorit AFAM (Ligji nr 508/99).

Ata të cilët nuk kanë marrë as diplomën e shkollës së mesme të lartë duhet te seleksionojnë Dëftesë liri (nga viti 2007 e quajtur "Diplomë e shkollës së mesme të nivelit të ulët") ose nisje profesionale (e marrë jo më pas vitit 1965").

Ata që mund të kenë ndjekur kursin integruar post-diplome duhet të seleksionojnë "Diplomë akademike e Formimit të Lartë Artistik, Muzikor dhe Koreografik (AFAM) të nivelit të I".

- Diplomë e marrë në Shkollën e Përkthyesve dhe Interpretuesve para ligjit nr 697/86. Ata të cilët kanë marrë tituj mbas reformës (Ligji nr 697/86), me titull të lëshuar nga Shkolla e mesme e ndërmjetësuesit gjuhësor, duhet të seleksionojnë (Diplomë universitare 2-3 vjeçare) e sistemit të vjetër (përfshirë shkollat e drejtpërdrejta me qëllime të veçanta ose parauniversitare)".



**MOD. 11 Diplomë universitare (2-3 vjeçare) e sistemit të vjetër (përfshirë shkollat e drejtpërdrejta me qëllime të veçanta ose parauniversitare)**

Titull i lëshuar në përfundim të kursit për diplomimin universitar dhe nga shkollat e drejtpërdrejta me qëllime të veçanta. Merret pas kursit të studimit i cili zgjat jo më pak se 2 vjet dhe jo më shumë se 3 (diplomë për statistikë, mbikëqyrje të shkollave fillore, Diplomë ISEF për edukimin fizik të sistemit të vjetër, diplomë paleografi dhe filologji muzikore, etj.). Janë të përfshirë titujt e lëshuara nga Shkolla e mesme për ndërmjetës gjuhësorë e krijuar pas reformës (Ligji nr 697/86).

**MOD. 12 Diplomë akademike e Formimit të Lartë Artistik, Muzikor dhe Koreografik) të nivelit të I**

I referohemi kurseve në fuqi pas reformës së sektorit AFAM (Ligji nr 508/99), tek të cilat hyn pas diplomimit në shkollën e mesme të lartë ose tjetër titull i marrë jashtë shtetit, i njohur. Përfshin diplomën akademike e marrë pranë Akademisë së Arteve të Bukura, pranë Akademisë kombëtare të Dramaturgjisë, Akademisë kombëtare të Vallëzimit, Konservatorin e Muzikës dhe Institutin e Lartë për Industrinë Artistike (ISIA)-kurse të sistemit të ri.

Korrespondojnë me diplomat e marra në fund të kurseve trevjeçare.

**MOD. 13 Diplomë e shkollës së lartë trevjeçare (të nivelit të parë) të sistemit të ri**

Pas reformës të shkollimit të lartë, janë parashikuar dy cikle të njëpasnjëshme: Diplomë e shkollës së lartë dhe të Specializimit/Magjistrale. Për të marrë diplomën e lartë trevjeçare të nivelit të parë janë të nevojshme 3 vjet.

**MOD. 14 Diploma akademike e Formimit të Lartë Artistik, Muzikor, dhe Koreografik (AFAM) të nivelit të dytë**

Të kuptohen kurset e aktivizuara pas reformë të sektorit AFAM (Ligji nr 508/99), në të cilat regjistrohen normalisht me diplomë akademike të nivelit të parë ose me diplomën e sistemit të vjetër apo me titull studimi të tjetër lloji i marrë jashtë shtetit dhe i vlefshëm. Në përfundim lëshohet Diploma akademike e nivelit të dytë. Përfshin Diplomën akademike e marrë në Akademinë e Arteve të Bukura, Akademisë Kombëtare dhe Dramaturgjisë, Akademisë Kombëtare e Vallëzimit, pranë Konservatorit të Muzikës dhe Institutit Të lartë për Industrinë Artistike (ISIA) - kurse të sistemit të ri.

Korrespondon me diplomat e marra kur përfundohen kurset dyvjeçare.

**MOD. 15 Diplomë dyvjeçare specializimi/master (i nivelit të II) të sistemit të ri**

Titull i përfituar në mbarim të kursit universitar dyvjeçar. Për tu regjistruar duhet të keni marrë fillimisht diplomën e shkollës së lartë të nivelit të I të sistemit të ri, diplomë universitare trevjeçare, diplomë akademike e nivelit të I.

**MOD. 16 Diplomë universiteti (4-6-vjeçare) e sistemit të vjetër, diplomë specializimi/master me cikël të vetëm e sistemit të ri**

- Diplomë e shkollës së lartë e sistemit të vjetër: titull studimi që përfitohet pas mbarimit të kursit universitar me program jo më pak se 4 vjeçar dhe jo më shumë se 6. për tu regjistruar në të duhet të kesh diplomën e shkollës së mesme (dëftesë pjekurie, kurs 4-5 vjeçar).
- Diplomë specializimi/Master me cikël të vetëm: titull studimi i cili merret pas përfundimit të studimeve të shkollës së lartë e cila zgjat jo më pak se 5 vjet dhe jo më shumë se 6. Për tu regjistruar në të duhet të kesh diplomën e shkollës së mesme (dëftesë pjekurie, kurs 4-5 vjeçar).

**MOD. 17 Doktoraturë/ Diplomë akademike për formim dhe kërkime shkencore AFAM**

Titull i marrë mas përfitimit të diplomës së shkollës së lartë ose diplomës AFAM (Diplomë universitare e sistemit të vjetër, Diplomë specializimi apo master me cikël të sistemit të ri, Diplomë dyvjeçare specializimi të nivelit të II e sistemit të sistemit të ri dhe diplomë AFAM e nivelit të II), pas mbarimit të cikleve studimore dhe kërkimesh shkencore personale i cila zgjat jo më pak se 3 vjet.

Nuk bëjnë pjesë në këtë model ata të cilët kanë përfituar titujt të tjerë studimi post-bachelor ose post-diplome AFAM.

**Pyetja 4.8 Në çfarë kursi jeni regjistruar?**

**MOD. 1 Shkollë fillore (arsimi fillor)**

Korrespondon me nivelin e parë të shkollimit dhe zgjat pesë vjet.

**MOD. 2 Shkolla dytësore e nivelit të I (shkolla e mesme e ulët)**

Korrespondon me nivelin e dytë themeltar të shkollimit dhe afat trevjeçar e përfaqëson përfundimin e ciklit të parë të shkollimit. Përfshin edhe ata të cilët janë regjistruar në një kurs para-akademik të Konservatorit ose Akademisë së Vallëzimit. Nëse bashkërisht po ndiqni një kurs shkollor, duhet të shkruani kursin shkollor dhe jo atë para-akademik.

### MOD. 3 Kurs trevjeçar ose viti IV për shkollimin dhe formimin profesional IFP

Përfshin kurset e shkollimit dhe formimit profesional (IFP) të cilët zgjasin tre/katër vjet, dhe zëvendësojnë tërësisht kurset e shkollave të mesme të gradës të dytë trevjeçare të cilat lëshojnë diploma kualifikimi profesional, këto janë çaktivizuar që prej vitit shkollor 2010/2011 pas reformës mbi studimet shkollore të arsimit të mesëm të gradës së dytë.

### MOD. 4 Shkolla e mesme e gradës së II

Përfshin kurset e studimit të së mesmes së lartë i cila zgjat 5 vjet, në përfundim të saj përfitohet dëftesa e pjekurisë me të cilën mund të regjistrohesh në universitet. Për tu regjistruar duhet të kesh marrë dëftesën e lirimit (ose dëftesë profesionale).

### MOD. 5 Kurs për shkollimin dhe formimin teknik superior IFTS

Përfshin kurset rajonale të nivelit post-dytësor, zakonisht me zgjatje njëvjeçare. Normalisht mund të regjistrohesh pas përfundimit të shkollës së mesme të lartë (pesëvjeçare) ose të diplomës profesionale për teknik, e lëshuar pas përfundimit të kurseve pesëvjeçare për formimin profesional (IFP-të viti IV). Lëshojnë Certifikatën e specializimit teknik të lartë.

### MOD. 6 Kurs për teknik i lartë ITS

Përfshin kurset për teknik i lartë (ITS) me afat dyvjeçar (rrallëherë mund të shtyhen deri në tre).

### MOD. 7 Shkollë e lartë e nivelit të I ose Master i nivelit të I

Kurs universitar i cili zgjat 3 vjet (niveli i parë), me mbarimin e të cilit lëshohet diploma universitare ose diploma trevjeçare sipas sistemit të ri të universiteteve.

Përfshin edhe kurset universitare të cilat zgjasin dy/tre vjet në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare ose diplomë trevjeçare (e sistemit të vjetër në përfundim tashmë) dhe kurset pranë Shkollave të drejtpërdrejta me qëllime të veçanta ose Shkollat parauniversitare. Si përfundim, përfshin kurset post-universitar (niveli I) për specializimin, për perfeksionimin ose Master i nivelit të I.

### MOD. 8 Kurs akademik i Formimit Të Lartë Artistik, Muzikor dhe Koreografik (AFAM) i nivelit të I; Kurs specializimi post-diploma akademik (përfshirë Master të nivelit të I)

Përfshin kurset akademike të Formimit të Lartë Artistik, muzikor dhe Koreografik me zgjatje trevjeçare (niveli i I), kurset akademike të sistemit të vjetër dhe kurset post-diploma AFAM të specializimit, dhe perfeksionimit ose Master i nivelit të I.

### MOD. 10 Kurs Universitar për specializim /magjistrale dyvjeçare

Kurs studimesh universitare i cili zgjat 2 vjet (niveli i dytë), në përfundim të tij lëshohet diplomë universitare e specializimit. Hyrja lejohet vetëm nëse është përfunduar shkolla e lartë e nivelit të parë e cila zgjat 3 vjet.

### MOD. 11 Kurs universitar i specializimit/magjstral me cikël të vetëm ose 4-6 vjeçar, Master i nivelit të II; Kurs specializimi universitar post-universitar

Kurs studimesh universitare që kohë zgjatin të paktën 4 vjet, në përfundim të tij lëshohet Diploma e nivelit të I universitar. Përfshin si kurset për të përfunduar shkollën e lartë në mënyre tradicionale të sistemit të vjetër, si edhe kurset e shkollës së lartë për specializim të përfunduara me sistemin e ri. Për tu regjistruar në këto kurse duhet të kesh marrë dëftesë e pjekurisë (kurs 4 ose 5 vjeçar).

Gjithashtu, janë përfshirë kurset post-Universitar të nivelit I për specializim, perfeksionim ose Master i nivelit të II.

### MOD. 12 Doktoraturë për kërkim shkencor ose Kurs për diplomë akademike të formimit për kërkim

Përfshin kurset universitare për doktoraturë për kërkim shkencor dhe për lëshimin e diplomës akademike të formimit për kërkim AFAM.

**Pyetja 4.9** Në javën nga 26 shtator dhe 02 tetor 2021 keni ndjekur kurse për formim /azhurnim profesional (falas ose me pagesë)?

Kurset e formimit profesional (falas ose me pagesë) mund të organizohen/financohen nga subjekte të ndryshme (biznese, organet publike dhe private) dhe shtrihen aktivitetet e ndryshme si për shembull: kurse gjuhe, informatike, parukeri, pastičeri, etj.

5

### Gjendja profesionale dhe jo profesionale

**Pyetja 5.1** Në javën që shkon nga 26 shtator e deri në 02 tetor 2021 keni kryer të paktën një orë punë?

Për punë kuptohet çfarëdolloj aktiviteti me arsye për të marrë pagë, rrogë, shpërblim, kompensim, fitim, etj. Nuk duhet të konsiderohen orët e harxhuara për të bërë punët e shtëpisë, mirëmbajtje të vogla ose riparime shtëpiake, pasione dhe të ngjashme.



## MOD. 1 Po

Bëjnë pjesë:

- Ata që në javën e referencës kanë kryer një ose më shumë orë punë të paguara si të punësuar ose si të vetë punësuar, duke kryer aktivitete të llojit të zakonshëm, të rastit ose stinore pavarësisht nga vazhdimësia dhe ekzistenca e një kontrate pune të rregullt. Duhet konsideruar çfarëdolloj pagese: rrogë, pagë, fitim, pagesa në natyrë, pagesë me të mbajtur, me të banuar ose tjetër, edhe nëse akoma nuk ju kanë paguar ose ju kanë paguar në një javë të ndryshme nga ajo e punës;
- personat në formim profesional, në mësimin e profesionit ose në stazh në qoftë se:
  - marrin një rrogë në para ose në natyrë (përfshijëmborsimet e shpenzimeve të dokumentuara, për shembull biletat e trenit);
  - veprimtaria e formimit profesional përkufizohet nga një kontratë ose nga një marrëveshje formale midis punëdhënësit e praktikantit, për një periudhë kohore midis 6 muajve e 6 vitesh, ku përcaktohen karakteristikat e veprimtarisë dhe alternimi i periudhave të mësimin teorik e formimit praktik me ato të punës së vërtetë;
  - plotësimi me sukses i rrugëtimit mundëson marrjen e një kualifikimi formal ose të një vërtetimi.
- punonjësit e pavarur që:
  - kanë punuar në ndërmarrjen ose studion profesionale të vet me qëllim që të realizojë një fitim edhe pse nuk e kanë arritur (ende) këtë objektiv;
  - kanë menaxhuar ndërmarrjen, studion e vet profesionale edhe duke mos realizuar shitje ose duke mos dhënë shërbime ose prodhuar të mira (për shembull për veprimtari mirëmbajtjeje, riparimi, riorganizimi ose pjesëmarrjeje në kongrese);
  - janë gati të hapin një kompani, një ndërmarrje bujqësore ose një studio profesionale e kanë blerë pasuri të tundshme e të patundshme, kanë instaluar pajisje ose kanë porositur furnizime me përgatitje të hapjes së aktivitetit të ri.
- mjekët që po specializohen, pra ata që janë regjistruar në Shkollën e specializimit mjekësor;
- Ata të cilët në javën e referencës kanë kryer një ose më shumë orë pune duke ndihmua një familjar ose një të afërm në aktivitetin e tij të pavarur, biznes ose firmë, pa qenë në marrëdhënieje pune me kontratë të rregullt dhe të pa paguar (**ndihmesa familjarë**, për

shembull bashkëshortja e cila ndihmon të shoqin në dyqan, fëmija që ndihmon babanë në bujqësi).

## MOD. 2 Jo

Bëjnë pjesë:

- ata të cilët në javën e referencës kanë kryer orë pune të pa paguara pranë organeve, instituteve, shoqatave dhe të ngjashme sepse vullnetar për kryerjen e aktiviteteve;
- ata që ndjekin kurse për doktoraturë për kërkim shkencor, edhe pse me bursë studimi - në rast se kjo është e vetmja punë e kryer në javën e marr në referim;
- ata që përfitojnë bursë studimi duke kryer aktivitete ekskluzivisht formuese;
- ata që në javën e referencës kanë bërë orë pune me qëllim që të marrin të ardhurat e shtetësisë në rast se janë të vetmet orë pune të bëra;
- punëtorët stinorë të cilët nuk kanë bërë orë pune gjatë javës në referim.

### **Pyetja 5.2.1 Cila është arsyeja kryesore për të cilën nuk keni punuar atë javë?**

Mungesa nga puna në javën e referencës mund të shkaktohet nga arsye të ndryshme. Përveç atyre më të natyrshme (pushime, sëmundje) rastet e mungesës mund të jenë:

- **Regjimi me orar fleksibël:** part time vertikal, lejet kompensuese, punën me turne, etj.
- **Leja e lindjes së detyrueshme për nënën ose babanë:** korrespondon me periudhën e detyrueshme të lejes së parashikuar nga ligji për t'u garantuar nënave, para e pas lindjes, një periudhë të mjaftueshme kurimi e pushimi (pesë muaj gjithsej).
- **Leja prindërore:** mungesë fakultative deri kur fëmija mbush dymbëdhjetë vjeç e mund të merret nga nëna ose nga babai që nuk shkojnë në punë për t'u kujdesur për fëmijën në moshë të re.
- **E ardhura nga papunësia [Arka për plotësimin e të ardhurave]:** përfshin atë që është përkohësisht i pezulluar nga puna dhe merr përfitimin e Arkës për plotësimin e të ardhurave [Cassa Integrazione Guadagni] të zakonshme ose të jashtëzakonshme.
- **Aktiviteti i reduktuar/mungesë pune, me përjashtim të CIG:** përfshin aktivitetin e reduktuar ose mungesën e punës të shkaktuar nga pandemia (COVID-19).
- **Arsye të tjera:** për shembull, asistencë sipas ligjit 104, aktiviteti i reduktuar i ndërmarrjes, etj.

I punësuari me leje prindërore duhet të përgjigjet “leje prindërore e paguar (edhe vetëm me kontribute), ose mungesë fakultative derisa fëmija mbush dymbëdhjetë vjeç” edhe nëse nuk merr rrogë por punëdhënësi ia derdh gjithsesi kontributet.

### **Pyetja 5.3** Ju kërkoni punë?

Përgjigjen “Po” edhe ata që do të fillojnë një punë brenda 3 muajve nga data e anketimit.

### **Pyetja 5.4** Në 4 javët që shkojnë nga 5 shtatori deri 2 tetor 2021 keni bërë diçka për të kërkuar punë?

Përgjigjen “Po” edhe ata që do të fillojnë një punë brenda 3 muajve nga data e anketimit.

### **Pyetja 5.5.14** Në 4 javët që shkojnë nga 5 shtatori deri 2 tetor 2021 keni bërë veprime të tjera për të kërkuar punë, që nuk përfshihen tek ato të mëparshmet (përfshihet pritja e rezultateve të veprimeve të mëparshme të kërkimit si: konkurse, intervista pune, etj.)?

Kush do ta fillojë punën brenda 3 muajve nga data e anketimit duhet të përgjigjet “Po”.

### **Pyetja 5.6** Nëse keni gjetur punë në javën që shkon nga 26 shtatori ne 02 tetor 2021 mund të ishit i gatshëm për të filluar atë javë ose brenda dy javëve të ardhshme?

Të përgjigjen “Po” edhe ata që do fillojnë punë brenda 3 muajsh nga data e Regjistrimit.

### **Pyetja 5.7** Keni kryer ndonjëherë në të shkuarën punë të paguar? Konsideroni punën si të pa paguar vetëm nëse është kryer në firmën e një të afërmi

Duhet të seleksionojnë “Po” ata të cilët edhe pse nuk punojnë tani por po kërkojnë punë, kanë kryer në të shkuarën punë të paguar ose falas, por në këtë rast si ndihmës familjar.

### **Pyetja 5.8** Çfarë lloji pune bëni?

#### **MOD. 1 Punë të vartur**

Punë e kryer, me ose pa kontratë, për një punëdhënësit shtetëror ose privat duke marrë pagesë në formë rroge,

pagë, rimbursim shpenzimesh, pagesë në natyrë, ushqim, banesë, etj.

Janë të përfshira edhe:

- Nxënësit punëto, praktikantët, stazhierët **me pagesë** (bursë studimi, çeqe për kërkime shkencore), pra ata që në aktivitetin e tyre alternojnë formimin, praktikën dhe punën;
- punëtorët e punësuar nga agjencitë e punës së përkohshme;
- ata që punojnë pranë banesës së tyre **në kushte vartësie me porosi** nga një ose më shumë firma;
- priftërinjtë dhe kleri i çdo feje;
- unëtorët shtëpiakë (bashkëpunëtores familjare ose gra të shërbimit, shoferë e kopshtarë);
- **ndihmësit familjarë të paguar** edhe në mungesë të një kontrate formale. Përkundrazi, nëse ndihmësi familjar **nuk merr asnjë pagesë**, atëherë duhet të seleksionojë “Ndhmës familjar”.

#### **MOD. 2 Bashkëpunim i organizuar dhe me vazhdueshmëri (me ose pa projekt)**

Karakteristikat e kësaj kontrate janë autonomia e bashkëpunësit, koordinimi i organizimit nga ana e porositësit, lloji më se personal i shërbimit etj.

#### **MOD. 3 Shërbimet e rastit**

Është një lloj bashkëpunimi jo i vartur për punime të rastit në të cilat punëtori duhet të dorëzojë një vepër apo ndonjë shërbim duke vendosur vetë si organizimin ashtu edhe kryerjen e saj. Duhet të kuptohen si punë të rastit marrëdhëniet të cilat nuk tejkalojnë, përgjatë një vit, tridhjetë ditët me të njëjtin porositës; pagesa e përgjithshme vjetore e përfituar prej porositësit nga punëtori nuk duhet të tejkalojë shumën e caktuar në 5000 euro. Punëtori i rastit kryen shërbimet e tij duke përfituar një shumë dhe tek e cila paguan tatim në burim pagese tek e llogaritur 20%. Nëse tejkalohej sasia vjetore e përfitimit e cila është 5000 euro duke mos marrë parasysh me sa porositës keni bashkëpunuar gjatë vitit, bashkëpunuesi është i detyruar të regjistrohet në degën e veçantë të Inps dhe të paguajë kontributet përkatëse.

#### **MOD. 4 Sipërmarrës**

Ai i cili organizon biznesin e tij (agrikulturë, industrial, tregtar, shërbimesh. Etj..) dhe mund të punësojë punëtores. Sipërmarrësi ka, pra, të paktën një punëtor dhe puna e tij kryesore është **organizimi dhe drejtimi** i aktivitetit të biznesit. Nëse, përveç organizimit dhe drejtimit të aktivitetit, personalisht merret me kryerjen e aktivitetit të procesit të prodhimit dhe kjo paraprin

administrimin atëherë do të jetë më e drejtë të shkruani “ I vetë punësuar”. Për shembull, një farkëtar i cili ka punishten e tij në të cilën punon edhe një punëtor, aktiviteti mbizotërues në këtë rast është ajo e farkëtarit sesa ajo e administrimit të punishtes.

#### MOD. 5 Profesionist i lirë

Ai që ushtron për hesap të tij një profesion apo art liberal (noter, avokat, mjek dentist, inxhinier ndërtimi. etj) në të cilën mbizotëron puna ose përpjekja intelektuale. Në këtë kontekst profesionisti i lirë mund të regjistrohet në dhomë profesionale ose jo.

#### MOD. 6 Punëtor i vetë punësuar

Ai i cili drejton një firmë bujqësore, një firmë të vogël industriale ose tregtare, një dyqan si artizan, dyqan publik, duke punuar në to edhe ai vetë- Hyjnë në këtë kategori kultivuesit e drejtpërdrejtë, bujqit më kontratë dhe të ngjashëm, kush punon në shtëpinë e tij për hesap të konsumatorit dhe jo me mandat nga bizneset. Punëtori i vetë punësuar mund të ketë të punësuar por mund edhe mos ti ketë. Ajo që e dallon nga të qenit sipërmarrës është fakti se është i përfshirë edhe vetë në shkallët e prodhimit dhe ky aspekt është parësor në krahasim me organizimin e aktivitetit. Pra, nëse punëtori ka të punësuar, aktiviteti i organizimit dhe drejtimit është parësor, prandaj është më e saktë të seleksionohet modaliteti sipërmarrës”.

#### MOD. 7 Ortak kooperative

Ai që është pjesëtar aktiv i një kooperative prodhimi mallrash dhe/ose shërbimesh të pavarura nga aktiviteti në të cilin vepron kooperativa, pra ai i cili si pagesë për punën e kryer nuk merr një shumë e normalizuar nga kontrata e punës por shpërblehet në proporcion me shërbimin e kryer ose/edhe nga kuota pjesë e fitimit të nxjerrë në fund vit.

#### MOD. 8 Ndhimës familjar

Ai që bashkëpunon me një familjar i cili kryen punë të pavarura, pa pasur marrëdhënie pune me kontratë të rregullt e **pa asnjë formë pagese** (për shembull gruaja që ndihmon burrin në dyqan, fëmija që ndihmon prindin bujk, etj.).

Përkundrazi, nëse ndihmësi familjar **merr pagesë**, atëherë duhet të seleksionojë “Një punë në vartësi”.

### Pyetja 5.9 Puna juaj është

#### MOD. 1 Me afat të përcaktuar

Marrëdhënie pune që përfundon kur verifikon kushtet objektive dhe të para përcaktuara (për shembull mbarimi i afatit, mbarimi i detyrave, arritja e një qëllimi, rikthimi i punëtorit momentalisht i zëvendësuar).

#### MOD. 2 E Përhershme

Marrëdhënie pune për tv cilën nuk ka datë përfundimi ose nuk i është vendosur afat.

### Pyetja 5.11 Ju kryeni punë

#### MOD. 2 Me kohë të pjesshme

I referohemi marrëdhënieve të punës e cila parashikon një numër orësh të reduktuara në krahasim me ato që normalisht kryejnë punëtorët e tjerë të ë njëjtës kategori.

Mund të jetë e llojit:

1. **horizontal:** kur puna kryhet e përditshme por me orar të reduktuar;
2. **vertikale:** kur puna përqendrohet vetëm në disa ditë të javës, ose në disa javë, ose në disa muaj të vitit;
3. **e përzierë:** kur orar i punës përfshin si sistemin horizontal edhe atë vertikal.

Edhe një punëtor i pavarur mund të kryejë punën e tij me kohë të pjesshme (për shembull një tregtar i cili kryen punën e tij në dyqan vetëm paradite ose vetëm pasdite punon me orar të reduktuar).

### Pyetja 5.13 Cili është sektori i aktivitetit ekonomik të fabrikës, organizmit, firmës, etj. në të cilën punoni ose jeni pronar?

Për të klasifikuar sektorin, referohuni:

- Lloji i aktivitetit (fabrikim, riparim, shitje me pakicë, etj.);
- all ose shërbime në objektin e aktivitetit (këpucë, makineri, pjesë ose komponentë, informatikë, pastrim, etj.).

Për shembull:

- fabrikim mobilierish;
- tregti me pakicë veshjesh.

Nëse në të njëjtën adresë/firmë kryhen më shumë se një aktivitet referohuni aktivitetit kryesor, pra atij prej të cilit keni më shumë fitime ose vlera të shtuara, duke ju përmbajtur kritereve të mbizotërimit:

- A) Prodhimi, i kuptuar si fabrikim, transformim dhe punim, mbizotëron mbi çdo aktivitet tjetër.
- B) Kultivimi mbizotëron mbi mbledhjen dhe tregtimin; tregtimi me shumicë mbizotëron mbi atë me pakicë; tregtimi në përgjithësi mbizotëron mbi prodhime të tjera jo prodhimtare (instalimi, riparimi, mirëmbajtja).

Në rast të aktivitetit të kryer në adresë ndryshe nga ajo e firmës përkatëse, referohuni aktivitetit ekonomik të firmës nga e cila vareni ose paguheni dhe jo asaj firme ku fizikisht kryeni punën (punëtori si roje i cili ka fituar

kontratë pune pranë bankës duhet ti referohet aktivitetit ekonomik të biznesit të tij dhe jo të asaj ku jep shërbim).

#### **MOD. 1 Agrikulturë, pylltari, gjueti dhe peshkim**

Kultivimi i kulturave agrare të përhershme dhe të përkohshme, riprodhimi i bimëve, rritja e kafshëve dhe bashkërisht me kultivimet agrare, gjuetia dhe kapja e kafshëve, pylltaria dhe përdorimi i zonave pyjore; peshkimi dhe kultura ujore.

#### **MOD. 2 Aktivitete ekstrakti nga gurorë ose miniera dhe shërbime ndihme për ekstraktin**

Ekstrakti i mineraleve që paraqiten në formë të ngurtë, të lëngut ose të gaztë. Ekstrakti mund të kryhet duke përdorur minierat nëntokësore ose mbitokësore, pusët, ekstrakte detare, etj. Janë të përfshira shërbimet e ndihmave të specializuara në aktivitete ekstrakti (shërbime për eksplorime të kryera me mbledhjen e kampioneve, shpimi, ndërtimi i themeleve për puse naftë dhe gazi, larja, larja dhe pastrimi i pusit, drenim dhe pompim i minierës, etj.).

#### **MOD. 3 Aktivitete e manufakturës dhe riparimit, mirëmbajtjes së makinave dhe makinerive**

Transformimi fizik ose kimik i materialeve, substancat ose komponentët e produkteve të reja ose këmbimin, rigjenerimin ose rindërtimin substanciale të prodhimeve.

Punimi, prodhimi dhe konservimi i të gjitha prodhimeve ushqimore; industria e duhanit dhe fibrave tekstile; konfeksionit dhe fabrikimit të artikujve për veshmbathje, peliçeve, lëkurës dhe përpunimit të saj; fabrikim i këpucëve, industria e drurit dhe fabrikimi i mobilieve; fabrikimi i prodhimeve me kashtë dhe materialeve përthurje; letër karton dhe artikujt përkatës; koks dhe prodhime që rrjedhin nga përpunimi i naftës; prodhime kimike dhe farmaceutike; bojëra, ngjyra dhe llak; artikuj gome dhe materiale plastike, prodhime xhami, porcelan dhe qeramikë; lëndë ndërtimore, lëndë metalurgjike; kompjuteri dhe prodhime elektronike, optike dhe elektrike; mjete transporti; stoli; instrumente muzikore; artikuj sportivë; lodra; instrumenti dhe pajisje mjekësore. Janë të përfshira edhe aktivitetet e shtypjes së gazetave, librave, rivistave, module tregtarë dhe materiale të tjera të përfshira ato ndihmëse, si libra lidhja, përgatitja e lastrave dhe përpunimi elektronik i teksteve dhe imazheve, riparimi, mirëmbajtja dhe instalimi i makinave dhe makinerive.

Është e përjashtuar riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, i cili hyn në "Tregtia me shumicë dhe pakicë e riparimit të automjeteve dhe motoçikletave", përjashtohet riparimi i kompjuterëve, mjeteve të komunikimit dhe mjeteve të tjera për përdorim personal dhe shtëpiak, të cilat futen në "Shërbime të tjera; riparime mallrash për përdorim personal dhe shtëpiak".

#### **MOD. 4 Furnizim me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar**

Prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektronike, gazit natyral, avullit, ujit të nxehtë dhe të kondicionerit nëpërmjet infrastrukturave fikse (rrjet) me linja, tuba ose konduktorëve. Përjashtohet administrimi i veçantë i konduktorëve të gazit, të cilët mbulojnë zakonisht distanca të mëdha dhe lidhin ndërmarrjet prodhimore me shpërndarësit e gazit ose me qendrat urbane (konduktorët e gazit futen në modulin "Transporte (të pasagjerëve ose mallra nëpërmjet konduktorëve, me anë të rrugës, rrugë ujore ose ajrore) magazinimin, ose shërbimet postare dhe aktivitetin e korrierit"). Përjashtohet administrimi i biznesit për firmat e shërbimit hidrik dhe kanalizimeve fekale (të cilat hyjnë tek "Furnizimi me ujë, menaxhimi i rrjetit të kanalizimeve fekale, aktivitete për administrimin e mbeturinave dhe aktivitete risistemimin e tyre").

#### **MOD. 5 Furnizimi hidrik, administrimi i rrjetit të kanalizimeve fekale, aktivitete për administrimin e mbeturinave dhe aktivitete risistemimin e tyre**

Mbledhja, trajtimi dhe furnizimi me ujë; administrimi i rrjetit të kanalizimeve fekale; mbledhja dhe filtrimi i ujërave të shkarkesës; mbledhja, trajtimi dhe eliminimi i plehrave të ngurta dhe jo të ngurta, të rrezikshme dhe të parrezikshme, rikuperimi dhe përgatitja e riciklimit të mbeturinave metalike, materiale plastike, plehrave të ngurta urbane, industriale dhe biomasave, aktivitete ripërtëritje (dezinfektim) të ndërtesave dhe vendeve, terrenit, i ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore.

#### **MOD. 6 Punime ndërtimore, vepra publike dhe instalime të shërbimeve në ndërtesa**

Ndërtime të pallateve, rrugëve, hekurudhave, metropolitane dhe pista ajrore, ndërtime të urave dhe galerive, vepra hidraulike dhe vepra me dobishmëri publike për energjinë elektrike dhe telekomunikimit; shembja dhe përgatitja e kantierëve ndërtimore; instalimi i impianteve elektrike ose hidraulike, vendosja e materialeve dhe kornizave, dyshemesë, etj.

#### **MOD. 7 Tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimet e automjeteve dhe motorëve**

Tregtia me shumicë dhe pakicë të çfarëdolloj malli. Përfshihet edhe riparimi, përveç shitjes, të automjeteve dhe motorëve. Përjashtohet shërbimi i ushqimit dhe pije për konsumim të menjëhershëm dhe shitja e ushqimeve më shërbim transportimi (restorant, bar, piceri, pub, ecc.) të cilat futen në modalitetin "Aktivitete i shërbimeve të ndenjes dhe restoranteve për konsumimin e menjëhershëm".

**MOD. 8 Transporti (i pasagjerëve ose mallrave nëpërmjet konduktorëve, mbi rrugë, rrugë ajrore ose ujore), magazinimi, shërbimet postare dhe aktiviteti si korrier**

Aktivitete të transportit të pasagjerëve ose mallrave të kryera në mënyrë të rregullt ose jo të rregullt nëpërmjet hekurudhës, konduktorëve, mbi rrugë, rrugë ajrore ose ujore dhe aktivitetet ndihmëse të kuptuara si shërbime terminal, administrimi i parkingut dhe garazheve, qendrat e lëvizjeve të mallrave (interport) dhe magazinimit të tyre etj., aktivitete qiradhënëse me shofer të mjeteve transportuese. Janë të përfshira edhe aktivitet postare dhe shërbimeve si korrier.

**MOD. 9 Aktivitete të shërbimeve të ndenjes dhe restoranteve për konsumimin e menjëhershëm**

Aktivitete hotelesh dhe ndenjes për periudha të shkurtra të vizitorëve dhe udhëtarëve (hotele me dhoma me qira, fshatra turistike, *hostel*, kamp. Etj.); aktivitete të shërbimeve restoranti të cilët shërbejnë vakte ose pije për konsumimin e menjëhershëm, pavarësisht nga lloji i strukturës e cila i ofron: restorante tradicionale, vetëshërbim ose konsumim jashtë lokalit, kioskë e përhershme ose e përkohshme me ose pa vende për tu ulur (dyqan akulloreje, ëmbëltore, mensë dhe *katering*, bar, *pub*, birrari, kafene, etj.).

**MOD. 10 Shërbime informacioni dhe komunikimi**

Aktivitete botimi përfshirë editimin e *software*, aktivitete të prodhimit kinematografik, video, programe televizive, audiovizuale dhe regjistrime muzikore dhe tingullore, telekomunikimet (linja fikse, të lëvizshme dhe satelitore), konsulentë informatikë dhe të gjitha aktivitetet për shërbimet informuese dhe atyre informatike (aktivitete i portaleve si kërkime në website, përpunimet e tv dhënave dhe të hosting, administrimi i data bazave, ecc.) aktivitete të agjencive të shtypit dhe atyre të agjencive të informacionit, imazheve dhe shërbimeve speciale ndaj mjeteve të komunikimit.

**MOD. 11 Aktivitete financiare dhe sigurimi**

Aktivitete ndërmjetësie financiare, përfshirë sigurimet, risigurimet dhe fondet për pensione (përfshihen sigurimet shoqërore të detyrueshme), aktivitetet ndihmëse të ndërmjetësive financiare (promotor, agjent, ndërmjetës dhe agjent shërbimesh financiare, aktivitete si *bancoposta*, shërbime për transferim parash si *money transfer*, etj.).

**MOD. 12 Aktivitete reale**

Aktivitete qiradhënies, agjentë dhe/ose ndërmjetës që veprojnë në fushën e një ose disa prej këtyre sektorëve: shitja dhe blerja e pronave, qiradhënies të pronave, shërbime të tjera reale si vlerësimi i pronës ose aktivitete të agjentëve reale për hesap të tretëve.

Aktivitetet e përfshira në këtë kategori mund të kryhen mbi pronat personale ose me qira por edhe për të tretët.

**MOD. 13 Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike**

Aktivitete të specializuara profesionale, shkencore dhe teknike për të cilat duhet të kesh nivel të lartë përgatitjeje dhe vendosin në dispozicion të personave aftësi dhe njohje të specializuara. Janë të përfshira aktivitetet e studiove ligjore dhe studiove të konsulentëve të biznesit, tatimoresh dhe revizion kontabël, aktivitete të administrimit të biznesit dhe konsulentë menaxhimi, aktivitetet e studiove teknike (arkitekturë, inxhinieri, projekt-kryes, hetim ndërtimor dhe hartimin dhe aktivitete për kolaudim fizik, kimik, ose lloji tjetër); aktivitete për kërkimin dhe zhvillimin në fushën e shkencave natyrore, të inxhinierisë, të shkencave njerëzore dhe humanistike, reklamim (shpikja e fushatave publicistike), kërkim të degëve dhe sondazhe me opinione, aktivitet të specializuar si disenjator (disenjatorë grafik, teknik, etj.), fotograf (prodhim të shërbimeve fotografike, aktivitet si fotoreporter, xhirime ajrore që i përkasin fushës së fotografisë, et) përkthim dhe interpretim, konsulentë bujqësor. Kjo kategori përfshin edhe aktivitetet e kryera nga veterinerët në klinikën veterinare ose pranë fermave, stelave për qentë, strehimet për kafshët, ambulatorë ose të tjera (përfshire shërbimet e ambulancës për kafshët).

**MOD. 14 Aktivitet qiradhënës, agjencitë e udhëtimit, shërbime ndihmëse për bizneset**

Aktivitete si qiradhënës dhe *leasing* operativ i mallrave jo reale dhe jo financiare si ashtu një sasi të gjerë mallrash materiale si automjete pa shofer ose operator, mjete transporti detar dhe ajror, mjete për zyrat (mobilie, kompjuter, fotokopjuese, etj.) mjete sportive dhe argëtimi, videokaseta dhe disqe, mjete bujqësore për punime ndërtimore dhe gjenisë shoqërore. Janë të përfshira aktivitetet e kërkimit shkencor, seleksionimin dhe punësimin e personelit, aktivitetet e agjencive të udhëtimit dhe operator turizmi, shërbimet e hetimit dhe mbrojtjes private dhe shërbimet e lidhura me sistemet e rojës (për shembull kontrolli me radio satelitore të mjeteve të transportit), aktivitete për pastrim dhe dezinfektim (të ndërtesave, makinave industriale, cisternave që transportojnë mbi rrugë toke ose deti), mirëmbajtja dhe kura e peizazhit përfshirë parqe, kopshte, vende me lule në ndërtesa dhe banesa publike dhe private) aktivitete *call-center in* dhe *out-bound*, ndihma në telefon organizime për fiera dhe konferenca, si edhe një seri aktivitetesh ndihmëse për bizneset (p.sh. Agjenci për rikuperim të kredive, kërkesa certifikatash dhe përfundim praktikash).

**MOD. 15 Administrata publike qendrore dhe lokale, Mbrojtja dhe sigurimet shoqërore të detyrueshme**

Aktivite të llojit shtetërore të kryera zakonisht nga administratat publike. Janë të përfshira aktivitetet e përgjithshme publike (për shembull administrimi ekzekutiv, legjislativ, financiar, etj. Në çdo nivel qeveritar), aktivite të punëve të jashtme, të mbrojtjes, rregullit dhe siguresës publike, të drejtësisë, aktivite si zjarrfikës dhe mbrojtjes civile, sigurime shoqërore të detyrueshme (INPS, INAIL, etj.).

**MOD. 16 Shkollim dhe formim publik dhe privat**

Shkollim, si publik ashtu edhe privat, të çfarëdolloj niveli ose profesioni. Aktiviteti mund të kryhet duke ndjekur leksione me gojë ose me shkrim, nëpërmjet radio, televizorit, internetit ose me korrespondencë. Përfshihet si shkollimi i shpërndarë nga institutet e ndryshme të sistemit kombëtar në tërësinë e niveleve, si edhe shkollimi për të rritur, programet kundër analfabetizimit etj. Janë gjithashtu të përfshira shkollat dhe akademitë ushtarake brënda burgjeve. Në këtë kategori hyjnë shkollimet e dhëna me qëllime sportive ose rikrijuese (mësimdhënia e tenisit, notit, kurse për aktrim, vallëzim, etj.) dhe aktivitetet e shkollës për patentë (auto shkollë, shkollë për pilot dhe lundrimi). Janë TË PËRJASHTUAR çerdhe shtetërore dhe private sepse hyjnë në "Shëndetësia dhe asistencat shoqërore rezidenciale dhe jo rezidenciale".

**MOD. 17 Shëndetësia dhe asistencat shoqërore rezidenciale dhe jo rezidenciale**

Shpërndarja e shërbimeve shoqërore dhe aktiviteve të asistencave shoqërore (rezidenciale dhe jo rezidenciale për pleq dhe persona me aftësi të kufizuara dhe strukturat e asistencës për personat me probleme mendore ose që përdorin drogë). Janë përfshirë vizitat mjekësore dhe trajtimet e dhëna nga mjekët e lagjes, specialistët, dentistët, etj.. Aktivitetet e parashikuara mund të zhvillohen në studio private, ambulatorë tek të cilët punojnë grupe mjekësh dhe nëpër klinika spitalore të cilat japin shërbime nëpër biznese, shkolla, azile pleqsh, organizata sindikale, por edhe në shtëpi të sëmureve.

**MOD. 18 Aktivite artistike, sportive, dhe të argëtimit dhe të dëfrimit**

Tërësia e aktiviteve të shërbyera për të kënaqur interesat e ndryshme kulturore, të spektaklit dhe argëtimit për publikun, dukë përfshirë spektaklet sy më sy, muzetë, bibliotekat, monumentet historike, rezervat natyrore, kopshtet gjeologjikë, struktura për lojëra dhe baste (kasinò, sallë bingo, sallë lojërash, etj.) aktivite sportive dhe rekreative (impiante sportive, klub sportiv, palestër, rezerva peshkimi dhe gjuetie, ludotekë, sallë

vallëzimi, plazhe, etj). Janë të përfshira aktivitetet e artistëve individualë.

**MOD. 19 Aktivite të tjera shërbimi; riparime të mjeteve për përdorim personal dhe shtëpiak**

Aktivite të organizatave shoqërore (i punëdhënësve dhe ekonomike, sindikatave të punëtorëve të vartur, partive dhe organizimeve fetare); aktivite të riparimeve të mjeteve për përdorim personal dhe shtëpiak; aktivite dhe shërbime për personat (lavanderi, ngjyrosje, parukeri dhe trajtime estetike, etj. Përfshihen aktivitetet e riparimit të kompjuterëve dhe aktivitetet lavanderi industriale.

**MOD. 20 Aktivite dhe bashkëjetesa si punëdhënës për personelin shtëpiak**

Aktivite familjare dhe bashkëjetesa (përfshirë administratat) si punëdhënës për personelin shtëpiak si bashkëpunuesit shtëpiak, kuzhinierët, kamerierët, mazhordom, larësit e rrobave, kopshtarët, portierët, shoferët, rojet, dadot, etj.

**MOD. 21 Organizatat dhe organizmat jashtë-territoriale**

Aktivite të organizmave ndërkombëtare si Shtetet e Bashkuara dhe agjencitë e tyre të specializuara, UE. OKSE, FMI, Banka botërore, etj.

**Pyetja 5.15 Gjatë javës nga 26 shtator deri në 02 tetor 2021 ju ishit**

**MOD. 1 Përfitues/e të një apo më shumë pensionesh me rrjedhje pune në të shkuarën ose përfitues/e të ardhurash si kapital**

- **Përfitues/e të një ose me shume pensione pune:** ai që përfiton një ose më shumë se një pensioni moshe/pleqërie ose invalidi. Këto shërbime njihen për faktin se personi nën mbrojtje ka punuar, janë arritur kushtet e moshës, plotësuar kushtet e kontributeve të derdhura dhe aftësia për punë është e limituar. Në këtë kategori hyjnë pensionet tip kompensimi të përbëra nga renta nga dëmtimet në punë ose sëmundjet profesionale. Karakteristikat e këtyre pensioneve është të dëmshpërblejë një person nga dëmtimi që ka pësuar, sipas gradës të dëmtimit, ose në rast vdekjeje (në këtë rast shifra u jepet të mbijetuarve të tij) si pasojë e një ngjarjeje e ndodhur përgjatë shërbimit në punë. Pensionet me kompensim njihen vetëm nëse janë derdhur kontributet minimale.
- **Përfitueset e rentës:** kush merr të ardhura, rentë ose fitime që si rrjedhje nga prona, investimet, interesat, qiratë, *royalties*, etj.



## MOD. 4 Kushte të tjera

Ata që ndodhen në kushte të tjera të ndryshme nga ato të lartpërmendura ( për shembull pensionist për arsye të ndryshme nga puna, përfituesi pensioni social, pensioni si invalid civil, etj.).

### 6 Vendi ku studion ose punon

#### Pyetja 6.1 Zakonisht ju duhet të lëvizni për të vajtur në vendin ku punoni ose studioni?

- Seleksiononi “Po, për të mbërritur në vendin ku studioj” edhe për fëmijët që shkojnë në çerdhe, kopsht, etj.
- **Studentët-punonjës** duhet të seleksionojnë “Po, për të shkuar në vendin ku punoj”.
- Punëtorët të cilët kryejnë pjesërisht aktivitetin e tyre në banesë dhe pjesën tjetër në vendin e punës (punë me anë të telefonit, *smart working*, punë e pjesshme horizontale) mund të seleksionojnë “Po, për të vajtur në vendin e punës” ose “Jo, sepse punoj nga shtëpia” duke ju referuar vendit (banesë/vend pune) në të cilin kalojnë pjesën më të madhe të kohës (ditëve të punës).
- Në rast punëtori bujqësor i cili punon në firma të ndryshme bujqësore, pra, nuk ka një vend pune fikse, seleksiononi modalitetin “Nuk kam vend pune fikse”.

- Seleksiononi modalitetin “Jo, sepse nuk studioj, nuk punoj dhe nuk ndjek kurse për formimin profesional” edhe nëse personi i shoqëron përditë fëmijët në shkollë por më pas nuk shkon në vendin e punës apo të studiojë.

#### Pyetja 6.3 Ku ndodhet vendi në të cilin zakonisht studioni ose punoni?

- Në rast se jeni punëtor i një firme i cila kryen, si rrjedhojë e një tenderi, shërbim mirëmbajtjeje tek ndonjë fabrikë, duhet të merrni në referim vendin ku ndodhet ajo fabrikë dhe jo adresën e firmës për të cilën punoni.
- Në rast se po kryeni aktivitet si konsulent në një seli apo firmë tjetër nga ajo për të cilën punoni ose nga firma juaj personale, referohuni adresës ku po kryeni aktivitetin si konsulent.
- Studentët-punonjës duhet të shkruajnë vendin e punës.
- Ata të cilët kryejnë shërbim mbi mjete transporti (shofer, makinist, shofer tramvaj, pilot, marinarë, etj.) duhet të shkruajë vendin nga merr shërbim (parking, stacion, depozitë, aeroport, port, etj.).
- Kush ka zakonisht dy vende studimi apo pune duhet t'ju referohet vendit kryesor ku punon apo studion.

#### Pyetja 6.4 Nga cila banesë niseni për të shkuar ku zakonisht studioni apo punoni?

### MOD. 1 Nga kjo banesë

Banesa në të cilën ju është dorëzuar kjo fletë nga Instat.